



Republika e Kosovës
Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)

Kodi i Etikës
i
Fondit të Kosovës për Eficiencë të
Energjisë

Përmbajtja

1	DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	3
2	RUAJTJA E INTEGRITETIT PERSONAL	3
3	QASJA E PUNONJËSVE TË FKEE NDAJ SUBJEKTEVE AFARISTE	5
4	MARRËDHËNIA E NDËRSJELLË MES PUNONJËSVE TË FKEE	5
5	MBROJTJA E PASURISË SË FKEE.....	7
6	PUBLIKU	8
7	KONFLIKTI I INTERESIT	8
8	ANKESAT PËR MOSPËRPUTHJE TË KODIT.....	9
9	HYRJA NË FUQI	11

Në bazë të paragrafit 4.1 të nenit 42 të Ligjit për Eficiencë të Energjisë Nr. 06/L-079 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2018/21) (në tekstin e mëtejshëm LEE), Bordi i Drejtorëve të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm FKEE) më 31. 01. 2019 nxjerr këtë:

Kod të Etikës të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë

1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kodi i Etikës së Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm: Kodi) përcakton rregullat e sjelljes për çdo person që vepron në kuadër të strukturave të FKEE-së, rregulla të cilat duhet respektuar gjatë kryerjes së detyrave të veta, për t'i kontribuar arritjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, avancuar vetëdijesimin mbi përgjegjësinë personale dhe profesionale, efikasitetin, mirësjelljen ndaj subjekteve afariste tjera dhe marrëdhëniet e ndërsjella me to, dhe reputacionin e FKEE dhe promovimin e kujdesit ndaj eficiencës së energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

2. Dispozitat e këtij Kodi janë të aplikueshme për të gjithë personelin e punësuar të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

3. Dispozitat e këtij Kodi janë të aplikueshme edhe për anëtarët e Bordit të Drejtorëve (në tekstin e mëtejshëm: Bordi) në përputhje me autorizimet dhe detyrat e tyre të përcaktuara me LEE, aktet nënligjore dhe Rregulloret e Brendshme të FKEE-së dhe Legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Kosovës.

2 RUAJTJA E INTEGRITETIT PERSONAL

Neni 2

1. Secili person që ushtron autorizime ligjore në kuadër të FKEE, duke përfshirë të gjithë punonjësit e FKEE, obligohen të respektojnë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet, rregulloret dhe rregullat e profesionit, standardet dhe praktikrat e mira të zbatueshme në Kosovë.

2. Punonjësit duhet të veprojnë në pajtueshmëri me udhëzimet e Drejtorit Menaxhues të FKEE apo eprorëve të tyre në FKEE, dhe në pajtim me aktet e brendshme dhe rregulloret e FKEE, mbi të cilat punonjësit konsiderohet se janë të informuar si duhet.

3. Gjatë kryerjes së detyrave, punonjësit obligohen të veprojnë me kujdes dhe në pajtim me proceset dhe procedurat e punës në FKEE. Në rast se dyshohet apo vërtetohet devijim nga to, punonjësit obligohen që për këtë menjëherë ta njoftojnë Drejtorin apo eprorët e tyre.

Neni 3

1. Anëtarët e Bordit obligohen që gjatë ushtrimit të funksioneve të FKEE-së:

1.1 si mbikëqyrës të afarizmit të FKEE-së, në vende publike të sigurojnë se nuk do ta dëmtojnë reputacionin e tyre personal, reputacionin e FKEE dhe besimin që në punën e saj e kanë subjektet afariste.

1.2 të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe objektive.

1.3 t'i trajtojnë dokumentet dhe informatat që kanë të bëjnë me aktivitete brenda fushëveprimit të FKEE në mënyrë konfidenciale, të sigurt dhe të rregullt.

1.4 të bashkëpunojnë në tërësi me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm të FKEE, duke ua siguruar atyre sipas kërkesës të gjitha dokumentet dhe dosjet elektronike dhe duke iu përgjigjur në të gjitha pyetjet e parashtruara.

2 Punonjësit e FKEE obligohen që gjatë ushtrimit të detyrave të FKEE-së:

2.1 në vende publike obligohen që të sigurojnë se nuk do ta dëmtojnë reputacionin e tyre personal, reputacionin e FKEE dhe besimin që në punën e saj e kanë subjektet afariste.

2.2 të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe objektive.

2.3 t'i trajtojnë dokumentet dhe informatat që kanë të bëjnë me aktivitete brenda fushëveprimit të FKEE në mënyrë konfidenciale, të sigurt dhe të rregullt.

2.4 të bashkëpunojnë në tërësi me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm të FKEE, duke ua siguruar atyre sipas kërkesës të gjitha dokumentet dhe dosjet elektronike dhe duke iu përgjigjur në të gjitha pyetjet e parashtruara.

Neni 4

1. Gjatë realizimit të mbikëqyrjes dhe aktiviteteve të FKEE, anëtarët e Bordit dhe punonjësit e FKEE nuk do të:

1.1 Pranojë para, pa marrë parasysh vlerën, apo vlerë apo metal të çmueshëm tjetër, apo të kërkojë pranimin e një dhurate,

1.2 Keqpërdorë pozitën e vet me qëllim të sigurimit të një përfitimi material apo tjetër personalisht, për anëtarë të familjes, të afërm, miq, persona tjerë juridikë apo fizikë me të cilët kanë marrëdhënie private, afariste apo politike,

1.3 Shfrytëzojë informatat zyrtare mbi funksionimin dhe punën e FKEE për përfitime personale apo të një personi tjetër,

1.4 Shfrytëzojë pozitën e vet për të ndikuar në vendimet e organit apo personit kompetent, për përfitim të vet apo në të mirë të një personi tjetër, për arritje të ndonjë privilegji apo të drejte për të kryer ndonjë transaksion juridik, apo në interes të një personi tjetër.

2. Nëse anëtarëve të Bordit apo punonjësve të FKEE u ofrohen benefite në formë të dhuratës apo ndonjë oferte tjetër, ata obligohen ta refuzojnë dhuratën apo ofertën tjetër dhe ta njoftojnë menjëherë Kryesuesin e Bordit apo eprorin e punonjësit të FKEE respektivisht.

3. Anëtarëve të Bordit dhe punonjësve të FKEE përgjegjës për mbikëqyrje u ndalohet të dalin në dreka e darka dhe të pranojnë dhurata nga persona të cilët i kanë nën mbikëqyrje. Gjatë kryerjes së punëve private, anëtarët e Bordit dhe punonjësit e FKEE nuk lejohen të shfrytëzojnë shenjat zyrtare apo autoritetin që e gëzojnë në vend të punës.

3 QASJA E PUNONJËSVE TË FKEE NDAJ SUBJEKTEVE AFARISTE

Neni 5

1. Punonjësit e FKEE obligohen t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha subjektet afariste, pa diskriminim apo preferencë në bazë të moshës, kombësisë, etnisë apo statusit social, gjuhës dhe origjinës racore, besimeve politike e fetare dhe bindjeve, paaftësisë, arsimimit, gjinisë, statusit familjar apo martesor, orientimit seksual apo në çfarëdo baze tjetër.
2. Punonjësit e FKEE obligohen t'u kushtojnë kujdes të veçantë personave me aftësi të kufizuara dhe personave tjerë me nevoja speciale.

Neni 6

1. Në lidhje me subjekte afariste, punonjësit e FKEE obligohen t'i trajtojnë ato profesionalisht, në mënyrë të paanshme dhe me mirësjellje, dhe të shfaqin interes dhe durim, duke u ofruar asistencë ligjore në pajtim me rregulloret ligjore në fuqi, duke iu përmbajtur parimeve të kosto-efektivitetit në procedurë.
2. Punonjësit e FKEE obligohen që ta aplikojnë njohurinë profesionale në mënyrë që subjekteve afariste t'u ndihmohet në ushtrimin e të drejtave të tyre, ndërsa të veprohet në pajtim me parimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjes së interesit publik dhe parimeve të llogaridhënies dhe sinqeritetit, efikasitetit, transparencës, cilësisë dhe mirëbesimit.
3. Të dhënat dhe informatat tek të cilat vijnë anëtarët e Bordit dhe punonjësit e FKEE gjatë ushtrimit të detyrave të tyre për FKEE mund të shfrytëzohen vetëm në mënyrën e përshkruar me ligjet e zbatueshme dhe me aktet e përgjithshme të FKEE.
4. FKEE si institucion publik, do të funksionojë në pajtim me standardet më të larta të transparencës ndaj opinionit publik. Megjithatë, disa të dhëna dhe informata të cilat janë në dispozicion të anëtarëve të Bordit dhe punonjësve të FKEE mund të jenë për nga natyra të ndjeshme. Prandaj, të dhënat dhe informatat do të klasifikohen në bazë të një rregulloreje të brendshme e cila adreson trajtimin e dokumenteve, në dy kategori kryesore: (i) publike dhe (ii) të dhëna të klasifikuara. Të gjitha të dhënat publike do t'i vihen në dispozicion opinionit publik dhe do të publikohen në faqen e FKEE në internet, ndërsa të dhënat dhe informatat e klasifikuara nuk do t'i zbulohen palëve të treta pa leje paraprake të Bordit apo Drejtorit Menaxhues, për arsye të qëndrueshme.
5. Në rregullore të brendshme FKEE do të përcaktojnë qartë rregullat dhe procedurat se si trajtohen të dhënat, informatat dhe dokumentet, përfshirë regjistrimin e tyre, disponimin me to, arkivimin dhe shkatërrimin e tyre. Punonjësit e FKEE obligohen t'u përmbahen këtyre rregullave.

4 MARRËDHËNIA E NDËRSJELLË MES PUNONJËSVE TË FKEE

Neni 7

Marrëdhënia e ndërsjellë ndërmjet punonjësve të FKEE bazohet në respektin e ndërsjellë, besimin, bashkëpunimin, mirësjelljen dhe durimin.

Neni 8

1. Gjatë kryerjes së detyrave të caktuara ditore, punonjësit e FKEE nuk mund të diskriminojnë persona të tjerë për shkak të prejardhjes së tyre, gjinisë, statusit social apo material, racës, përkatësisë kombëtare apo fetare, orientimit seksual apo për ndonjë arsye tjetër në kundërshtim me Kushtetutën dhe të drejtat dhe liritë ligjore.
2. Çdo ngacmimi seksual, ndjekje dhe abuzim fizik i punonjësve të FKEE është i ndaluar.
3. Punonjësit e FKEE nuk mund të ndërhyjnë me punonjësit e tjerë në kryerjen e detyrave të tyre.
4. Punonjësit e FKEE janë të obliguar të këmbëjnë opinione dhe informata mbi çështjet specifike profesionale.

Neni 9

Mbikëqyrësit në FKEE kërkohet t'i inkurajojnë punonjësit që të punojnë me standardet më të larta të cilësisë dhe efikasitetit, ta respektojnë njëri-tjetrin, të bashkëpunojnë dhe dëshmojnë qëndrim të duhur ndaj subjekteve afariste.

Neni 10

Punonjësit e FKEE janë të obliguar të vishen në mënyrë adekuate, dhe veshmbathja duhet të jetë e përshtashme për vendin e punës dhe detyrat e kryera.

Neni 11

Punonjësit e FKEE janë të obliguar t'i trajtojnë asetet e FKEE dhe mjetet financiare të besuara të ta dhe të kushtuara për përdorimin e tyre me kujdes të madh dhe në mënyrë të përgjegjshme.

Neni 12

1. FKEE është i obliguar të ofrojë kushte të sigurta pune, që nënkupton që punonjësit e saj nuk do të ekspozohen ndaj rreziqeve shëndetësore dhe rreziqeve të tjera, t'u sigurojë atyre pajisje personale mbrojtëse për punën në terren dhe t'u ofrojë informata të duhura dhe sigurime adekuate për rreziqet e mundshme.
2. Në mjediset e FKEE nuk lejohet pirja e duhanit, përveç në hapësira të veçanta të dedikuara enkas për këtë qëllim, por që duhet të përmbushë standardet përkatëse në përputhje me legjislacionin në Kosovë.
3. Nuk ka tolerancë për abuzim të drogës dhe alkoolit në mjediset e FKEE, që është në interes të punonjësve për të ruajtur shëndetin, reputacionin e FKEE dhe për të siguruar cilësinë e shërbimeve të FKEE.
4. Është e ndaluar që një Anëtar i Bordit dhe punonjës i FKEE të jetë nën ndikimin, të përdor, konsumojë, prodhojë, shesë, shpërndajë ose përpunojë droga ilegale gjatë gjithë kohës gjatë kohës gjersa është duke punuar ose përfaqësuar FKEE.
5. Armët, duke përfshirë, mes tjerash, thikat, armët e zjarrit dhe eksplozivët, nuk lejohen në ndërtesën e FKEE dhe automjetet e përdorura nga FKEE.

6. Çdo bagazh i sjellë në mjediset e FKEE dhe/ose automjetet e përdorura nga FKEE mund të kontrollohet nga personat e autorizuar nga FKEE.

Neni 13

Sipas mundësive, FKEE kërkohet të investojë në zhvillimin e punonjësve të saj dhe të krijojë një mjedis stimulues për punë inovative dhe kreative.

Neni 14

Të dhënat personale mbi punonjësit ose kandidatët për punë në poste të shërbimeve të ekspertëve të FKEE mbrohen në përputhje me rregulloret në fuqi.

5 MBROJTJA E PASURISË SË FKEE

Neni 15

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, punonjësit janë të detyruar të kujdesen për përdorimin e pasurive të FKEE në përputhje me politikat dhe procedurat e përshtatshme, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me mbajtjen e disponueshmërisë dhe vlerës së zyrave dhe pajisjeve (mobile, pajisje të TI, etj.).

Neni 16

1. Të gjitha pasuritë e FKEE duhet të përdoren për qëllime të ligjshme biznesi. Punonjësi nuk duhet të marrë, huazojë, shesë, dëmtojë asetet e FKEE, ose të lejojë të tjerët të përdorin asetet e FKEE për qëllime jashtë fushëveprimit të FKEE. Çdo keqpërdorim i pronës së FKEE me qëllim sigurimit të fitimit personal ose fitimit për një palë të tretë lidhur me punonjësit e përfshirë do të sanksionohet.

2. Çdo vjedhje ose përdorim i paautorizuar i pasurive të FKEE me pasoja të konsiderueshme negative ekonomike për FKEE konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe çon në ndërprerje të punësimit pa paralajmërim.

Neni 17

1. Punonjësit duhet të përdorin sistemin e TI të FKEE në mënyrë të arsyeshme dhe të përgjegjshme.

2. Vetëm aplikacionet (softuerë) e miratuara, licencuara dhe instaluar nga personat përgjegjës për TI brenda FKEE mund të instalohen në kompjuterët e punonjësve.

3. Punonjësit nuk kanë të drejtë të:

3.1 marrin pjesë në një punë që nuk është miratuar nga FKEE,

3.2 dërgojnë mesazh apo informacion që mund të jetë ofendues ose shpifës ndaj pranuesit, duke rrezikuar kështu marrëdhënien biznesore,

3.3 shfaqin ose transmetojnë programe që janë shkatërruese për të dhënat në kompjuter.

6 PUBLIKU

Neni 18

1. Drejtori Menaxhues i FKEE, zëdhënësi i FKEE ose personi i autorizuar nga Drejtori Menaxhues janë personat e vetëm të autorizuar për të dhënë informata publikut mbi punën e FKEE. Në kryerjen e kësaj detyre, personat e autorizuar janë të detyruar të zbatojnë paragrafin 4 të nenit 6.

2. Në të gjitha format e paraqitjeve publike dhe aktivitetet në të cilat përfaqësohet FKEE, punonjësve u kërkohet të paraqesin pikëpamjet e FKEE në mënyrë profesionale dhe të përgjegjshme, në përputhje me rregulloret, kompetencat dhe udhëzimet e dhëna, si dhe dispozitat e këtij Kodi.

7 KONFLIKTI I INTERESIT

Neni 19

1. Mendimi i pavarur i ekspertëve është një nga vlerat kryesore për funksionimin e suksesshëm të FKEE, si në rastin e anëtarëve të Bordit ashtu edhe të punonjësve të FKEE. Shmangia e konflikteve të interesit në të dyja nivelet është garanci për arritjen e këtij qëllimi.

2. Konflikti i interesit ndodh kur interesat personale të individëve në ndonjë mënyrë ndikojnë ose bien ndesh me interesat e FKEE. Situata e konfliktit të interesit lind kur një anëtar i Bordit ose punonjësi i FKEE ndërmarrin procedura ose kanë interesa (personale, familjare, financiare, politike ose sociale) që mund të pengojnë kryerjen objektive dhe efikase të aktiviteteve të FKEE. Gjithashtu, konflikti i interesit mund të lindë nga një anëtar i Bordit dhe/ose punonjës i FKEE nëse anëtarët e familjes së tij/saj marrin përfitime personale të pahijshme si rezultat i pozitës së tij/saj, pavarësisht nëse këto përfitime janë përvetësuar në mënyrë direkte ose indirekte.

3. Përveç dispozitave të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Anëtarët e Bordit të KEEF dhe stafi i FKEE nuk do të jenë në ndonjë situatë konflikti interesi siç parashihet me ligjin në fuqi të Kosovës për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Neni 20

1. Anëtarët e Bordit dhe punonjësit e FKEE janë të detyruar të identifikojnë me kohë konfliktet e mundshme të interesit dhe t'i parandalojnë ato.

2. Në rast të konfliktit ekzistues të interesit, Anëtarët e Bordit Drejtues të KEEF-së duhet t'a informojnë menjëherë Kryesuesin e FKEE-së dhe të përjashtohen nga procedurat që mund të kenë pasoja negative për FKEE.

3. Në rast të konfliktit ekzistues të interesit, punonjësit e KEEF-së duhet t'i informojnë menjëherë mbikëqyrësit e tyre apo Drejtorin Menaxhues të KEEF-së dhe të përjashtohen nga procedurat që mund të kenë pasoja negative për FKEE.

Neni 21

1. Për të shmangur konfliktin e interesave, anëtarët e Bordit dhe punonjësit e FKEE nuk do të:

1.1 pranojnë ose kërkojnë të marrin aksione të biznesit nga bashkëpunëtorët afaristë, ose nga kompanitë që do të bëhen bashkëpunëtor afaristë që mund të ndikojnë në vendimet e tij/saj të biznesit,

1.2 marrin vendime mbi çështjet kur interesat personale në mënyrë të arsyeshme mund të rrezikojnë marrjen e vendimeve të mira për FKEE,

1.3 punësohen nga persona të tjerë tjetër ose të marrin kompensim për veprimtari afariste që mund të ndikojnë në FKEE,

1.4 përfitojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, fitime personale nga shitjet ose blerjet në FKEE ose që ai/ajo ka gjeneruar përfitime afatgjata nga një veprimtari tjetër e FKEE,

1.5 pa miratim paraprak të FKEE, nuk ofrojnë shërbime për ndërmarrje të tjera afariste që mund të ndikojnë negativisht në performancën e tyre në FKEE ose mund të rrezikojë interesat e FKEE, duke përfshirë shërbimet në cilësinë e drejtorit, punonjësit ose konsulentit,

1.6 udhëheqin ose të kërkojnë të kryejnë, pa miratimin paraprak, çdo veprimtari të FKEE me një ndërmarrje tjetër në të cilën një punonjës ose anëtar i familjes ka pozitë të pronarit ose është menaxher,

1.7 shesë ose blejë nga një bashkëpunëtor afarist mallra ose shërbime, përveç nëse janë në rrjedhën normale të biznesit,

1.8 huazojë ose jep hua para për një person që është bashkëpunëtor afarist.

Neni 22

1. FKEE-ja nuk do të punësojë më shumë se një person nga e njëjta familje. Për qëllime të këtij Kodi "anëtar të familjes", konsiderohen të jenë i fejuar ose bashkëshort; fëmijë biologjik ose i adoptuar, djalë ose vajzë e bashkëshortit, nipa dhe mbesa, prindër dhe gjyshër; motra, vëllezër; xhaxhallarë, halla dhe nipër.

2. Anëtarët e Bordit dhe punonjësit e FKEE nuk duhet të jenë persona nga e njëjta familje në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

8 ANKESAT PËR MOSPËRPUTHJE TË KODIT

Neni 23

1. Subjektet afariste (personat juridik dhe fizik dhe qytetarët) dhe punonjësit e KEEF mund të bëjnë ankesë lidhur me sjelljen e punonjësve të FKEE ose të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, të cilët konsiderojnë se janë në kundërshtim me këtë Kod, rregulloret e tjera të FKEE dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

2. Punonjësit e FKEE dhe anëtarët e Bordit të FKEE kanë të drejtë dhe obligohen të kërkojnë zgjidhje të çështjes së pari brenda FKEE në përputhje me dispozitat e rregullave të punës, që përfshijnë angazhimin e mundshëm të Komisioneve Dicipline. Në rast të situatës nga paragrafi 1 i këtij neni dhe pa aftësisë për të gjetur një zgjidhje të pranueshme reciprokisht, në diskutim të drejtpërdrejtë miqësor me Drejtorin Menaxhues, Drejtorin Menaxhues ose Kryesuesin e Bordit (*e aplikueshme për Anëtarët e Bordit*), FKEE është i detyruar ta dorëzojë rastin në Komisioni Disiplinor brenda 15 ditëve nga referimi i çështjes në bazë të paragrafit 1 të këtij neni.

3. KEEF do të themelojë Komisionet Disiplinore që do të jenë të autorizuara të nxjerrin masa disiplinore për punonjësit e FKEE dhe për anëtarët e Bordit të Drejtorëve të FKEE-së .

4. Komisioni Disiplinor përgjegjës për nxjerrjen e masave disiplinore për punonjësit e FKEE përbëhet nga tre (3) anëtarë të stafit të FKEE dhe do të themelohet nga Drejtori Menaxhues.
5. Komisioni Disiplinor përgjegjës për nxjerrjen e masave disiplinore për anëtarët e Bordit të Drejtorëve të FKEE përbëhet nga tre (3) anëtarë të Bordit të Drejtorëve dhe themelohet nga Bordi i Drejtorëve.
6. Vendimi i Komisionit Disiplinor duhet të jepet në formë të shkruar Drejtorit Menaxhues në bazë të paragrafit 4 të këtij neni apo Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve në bazë të paragrafit 5 të këtij neni, brenda 30 ditëve kalendarike nga themelimi i Komisionit Disiplinor.

Neni 24

1. Në rast të shkeljes së të drejtave ligjore ose kontraktuese dhe dispozitave të këtij Kodi, mund shqiptohen masat disiplinore në vijim:

- 1.1 paralajmërim verbal;
- 1.2 paralajmërim me shkrim;
- 1.3 degradimi nga posti / pozita;
- 1.4 Pezullimi i përkohshëm;
- 1.5 ndërprerja e marrëdhënies së punës.

2. Masat disiplinore, paralajmërimi verbal, paralajmërimi me shkrim dhe degradimi nga pozita do të shqiptohen për shkelje të lehtë të detyrave të punës së FKEE në përputhje me të drejtat ligjore dhe kontraktuale, dispozitat e këtij Kodi, rregulloret e brendshme të FKEE dhe kontratën e punës.

3. Masat disiplinore, si gjoha, pezullimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës vendosen për shkelje të rëndë të detyrave të punës së FKEE në përputhje me të drejtat ligjore dhe kontraktuale, dispozitat e këtij Kodi, rregulloret e brendshme të FKEE dhe kontratën e punës.

Neni 25

1. Drejtori menaxhues ose Bordi i Drejtorëve do të zbatojë vendimin tek punonjësi / anëtari i Bordit të Drejtorëve brenda 15 ditëve të punës pas pranimin të vendimit nga Komisioni Disiplinor i përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 23 të këtij kodi të etikës. Në rast të ankesës në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, afati zgjatet deri sa të jepet vendimi i Drejtorit Menaxhues/Bordit të Drejtorëve në bazë të paragrafit 2 të këtij neni.

2. Punonjësi mund të apelojë vendimin e Komisionit disiplinor te Drejtori Menaxhues brenda 15 ditëve të punës dhe të kërkojë rishikimin e procedurës. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të apelojnë vendimin në Bordin e Drejtorëve.

3. Në rast se mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me mjete paqësore, punonjësit e FKEE kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtje para gjykatës.

4. Në rast se Bordi i Drejtorëve vendos të imponojë masat disiplinore të parashikuara në nën-paragrafin 1.5 të Nenit 24 të këtij kodi ndaj një anëtar të Bordit të Drejtorëve, Bordi do të kërkojë nga institucioni emërues Bazuar në Ligjin për Eficiencën e Energjisë që të zëvendësojë një anëtar të tillë.

9 HYRJA NË FUQI

Neni 26

1. Secili anëtar i Bordit dhe punonjës i FKEE, si dhe punonjësi i ri, do të pajiset me një kopje të këtij Kodi, i cili vërtetohet me nënshkrimin e Deklaratës së Pranimi të Kodit, para fillimit të veprimitarisë në Bord ose nënshkrimit të kontratës së punës.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të FKEE në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të FKEE-së

Lum Mita

Datë, 31. 01. 2019